

VENDIM
Nr.654, datë 17.10.2005

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PËRFAQËSUESIT TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NË GRUPIN MBIKËQYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “ Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Farudin Arapi, anëtar, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në grupin mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Nexhat Veipi emërohet anëtar, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në grupin mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha